



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

VENDIM

Nr. 5 /2024

Në mbështetje të nenit 12 dhe vijues të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Kryetares së Kuvendit,

KONFERENCA E KRYETARËVE

VENDOSI:

1. Në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të krijohet hapësira dhe kushtet e nevojshme nëpërmjet një mekanizmi të barabartë dialogu mes shumicës dhe pakicës parlamentare, që në mënyrë transparente, trajton me qëllim gjetjen e konsensusit, çështje që kërkojnë diskutim politik konstruktiv e gjithëpërfshirës, ligjet që kërkojnë shumicë të cilësuar dhe legjislacionin e nevojshëm për ecurinë e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
2. Ngarkohet Kryesia e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për përcaktimin e rregullave të funksionimit për sa parashikohet në këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 15/03/2024

KRYETARJA

Lindita NIKOLLA

